fjala.
publishing

Rolf Lappert

BLUZ
në
HUMBËTIRË

Roman për të rinj

Përktheu Sokol Mici

fjala.
publishing

traduki

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria Federale për Evropë, Integrim dhe Punë të Jashtme e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni zviceran "Pro Helvetia", "KulturKontakt Austria" (ngarkuar nga Zyra e Kancleariт Federal të Republikës së Austrisë), Instituti "Goethe", Agjencia Sllovene e Librit "JAK", Ministria e Kulturës e Republikës së Kroacisë, Departamenti i Kulturës i Qeverisë së Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe e Informimit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Republikës së Rumanisë, Ministria e Kulturës e Malit të Zi dhe Fondacioni "S. Fischer.

Titulli i origjinalit: *Pampa Blues*

Copyright © Carl Hanser Verlag München 2012.

Copyright © of the translation: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI

© Të gjitha të drejtat e botimit në gjuhën shqipe i takojnë Shtëpisë Botuese "Dudaj"

Redaktor: Sejdin Cekani
Kopertina: Studio grafike
Designer: Vlash Papa
Përpunimi grafik: Greta Konomi

fjala. publishing

ISBN 978-9928-176-23-3
Shtypur në Shtypshkronjën "Guttenberg"
Tiranë, 2016

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova",
Pall. 28, Ap. 29. Tiranë.
Tel. - fax.: 00355 4 2249 944
E-mail: info@botimedudaj.com
Website: www.botimedudaj.com

Me dashuri, në kujtim të gjyshërve
Walter dhe Frieda Metz.

Shtëpia është atje ku e vënë re
që ti nuk je më aty.

ALEKSANDAR HEMON, LAZARUS

1

E urrej jetën time. Për tre vjet mbush njëzet, që do të thotë gjysma e dyzetës. Për tetë vjet Karli mbush nëntëdhjetë, kurse unë do të jem njëzet e pesë dhe ndoshta ende këtu. Bashkë me të. Tani për tani as që dua ta mendoj këtë. Më del e më tepron realiteti.

Kam përpara Karlin, krejt lakuriq. Supet kockë e lëkurë i ka të mbuluara me shkumë si borë. Megjithëse në banjë është ngrohtë, dridhet pak nga i ftohti. Pasqyra është veshur me avull, shtëllunga të të cilit lundrojnë nën tavan. Ia fshij shpinën me peshqir, se nuk e bën më dot vetë. Po t'jua numëroja të gjitha ato që Karli nuk i bën më dot vetë, do të duhej të mbushja libra të tërë. Iu morën këmbët, ndaj zgjati duart që të mbahej pas murit. Pas gjashtëdhjetë e pesë vjetëve, unë do të jem në moshën e tij tani.

- Na, allatet fshiji vetë, - i them unë duke ia zgjatur peshqirin.

- Më pëlqen kjo 'allatet', - mërmëriti Karli duke u zgërdhirë.

Ndonjëherë Karli i kupton mirë të gjitha, madje edhe batutat më të holla. Në raste të tilla e ka kokën si një radio e vjetër që i ndizen llambat e pluhurosura dhe bëhet gati të kapë stacionet. Por shumicën e kohës kupton vetëm fjali të thjeshta, ndërsa në ditë të këqija vetëm fjalë të veçanta, si: ha, fle apo biskota. Karli e ka marrë tashmë të tatëpjetën. Kur të mos i punojë më truri, nuk do të arrijmë më të bisedojmë me njëri-tjetrin. Por nuk di ta them nëse do të më mungojë.

Kur mbusha pesëmbëdhjetë vjeç, fillova të mësoj për kopshtari me Karlin. Nëna ime thoshte se kjo ishte një ide

gjeniale, por në të vërtetë ishte një zgjidhje nga halli, nga më të thjeshtat, për të më hequr qafe pas vdekjes së babait. Se Karlit nuk i lejohej më fare të përgatiste nxënës. Megjithëse atë kohë truri vazhdonte t'i funksiononte ende mirë, ishte plak, gjunjët i kishte copë dhe punonte sa për qejf. Gjithsesi, nuk e di, por ime ëmë arriti ta rregullonte punën me autoritete përkatëse. Mendoj se për shkak të numrit të madh të atyre që lënë shkollën dhe të rinjve të papunë në zonë, nëpunësit përgjegjës as që e çajnë kokë fare se ç'bëj unë këtu. E rëndësishme për ta është që jam sistemuar, nuk hallavitem kot vërdallë dhe nuk drogohem.

Karli më mësoi të mbjell lule me zhardhok, të krasis gëmushat e trëndafilave dhe të nxjerr fidanët nga vazot. Më mësoi si ta kompostoj sa më mirë dheun dhe si t'i zhduk morrat e gjetheve. Di të dalloj karafilat e egër nga ata të Grenobelit dhe di të përdor mirë si prashajkën, ashtu dhe sfurkun. Ajo që s'kam mësuar dot këtu është se si funksionon bota tjetër dhe çfarë ndjesie ke kur prek një vajzë lakuriq.

Çdo të enjte, një vit me radhë, nëna më çonte dhe me merrte me makinë nga shkolla profesionale në qytet, një orë vajtje dhe një orë ardhje. Nëna është këngëtare. Gjatë asaj kohe ajo jepte shfaqje me grupe kërcimi nëpër festa private, festa firmash biznesi dhe dasma. Në të vërtetë është këngëtare xhazi dhe bredh me kuartetin e saj nëpër Europë nga klubi në klub. Grupi i saj përbëhet nga ajo, një pianist, një saksofonist, një kitarist bas dhe bateristi. Në fotografinë për shtypin ka dalë me një fustan të gjatë të zi dhe me doreza që i shkojnë deri në bërryl, kurse katër muzikantët e tjerë janë me smoking dhe me papion. Të gjithë kanë dalë duke buzëqeshur. Poshtë fotografisë është shkruar me germa të lakuara: Betty Black & Emerald Jazz Band. Mbiemri i vajzërisë i nënës është Paslak, Betina Paslak. Po ky emër i dukej se tingëllonte më shumë si prej qytetit të humbur Neu Ruppin dhe jo mjaft njujorkez. Shilling, mbiemrin e babait tim, nuk e ka mbajtur kurrë. Në pasaportën e saj shkruhet: Betina Shilling- Paslak, po në botën e muzikës njihet vetëm

me emrin e saj të skenës. Udhëton shumë në të gjithë Europën, duke filluar nga Palermoja e deri në Helsinki, nga Alikante në Varshavë. Po gjithsesi karrierë nuk ka bërë dot. S'e kam idenë pse. Ndoshta i mungon ambicia, nxitja e duhur ose një menaxher i mirë. Ose ka zë mesatar. Pastaj xhaz. Dua të them, e kush dëgjon xhaz sot!

Pas dushit, e ndihmoj Karlin të vishet dhe pastaj bëj drekën. Karli shtron tryezën. Zonja Vernike, infermierja, që vjen një herë në javë për të vizituar Karlin, më ka thënë t'i jap detyra të vogla që të vërë trurin në punë. Një nga detyrat e Karlit është të shtrojë tryezën tri herë në ditë. Zonja Vernike thotë se ky është një lloj ushtrimi për të rritur kapacitetin mendor, po në rastin e Karlit duket se nuk funksionon mirë. Zakonisht harron ndonjë gjë, herë lugën, herë filxhanët dhe herë të dyja pecetat. Shpesh, bri pjatave vë dy pirunë, po jo thikë, ose shtron filxhanë kafeje në vend të gotave të ujit. Ngandonjëherë rri më këmbë përpara tryezës bosh, se nuk mban mend çfarë duhet të bëjë. Në këtë situatë jam unë ai që nxjerr pjatat, lugët e pirunët dhe i tregoj çfarë të bëjë. Kur është në ditë fare të keqe dhe rri duke rrotulluar ndonjë lugë në duar pa ditur ç'të bëjë, i them të ulet në karrige dhe e vë të presë copa letre.

Karli sot është në ditë shumë të mirë. Thikat dhe pirunët i ka vënë në anën e gabuar, por ama, nga ana tjetër, me përjashtim të pjatëzave për filxhanët dhe pecetave, nuk ka harruar gjë tjetër. Sot ka veshur çorape të zeza, një palë pantallona të gjëra ngjyrë gri dhe një këmishë të bardhë. Sikur të ishte rruar, do të kishte një pamje krejtësisht të pranueshme. Nxjerr pecetat nga sirtari, ia fiksoj njërën Karlit në jakën e këmishës dhe ia përvesh edhe mëngët.

- Faleminderit! - më thotë. Mesatarisht me falënderon rreth dhjetë mijë herë në ditë, kur e ndihmoj të veshë pantoflat, kur ia lyej bukën me gjalpë apo ia fshij xhamat e syzeve.

- Të bëftë mirë! - ia kthej unë.

- Faleminderit ! - përgjigjet ai.

Kutia e biskotave, te këmbët e tij, poshtë në dysheme, është e mbushur plot e përplot me copa letre sa thoi i gishtit të madh të dorës, në të gjitha nuancat e ngjyrës blu.

Në mëngjes, kur qëllon që ngrihem mahmur, apo në mbrëmje, kur kam pasur ndonjë ditë të keqe dhe nuk dua të dëgjoj zhurmat që bën Karli duke ngrënë sikur dihat rëndë, rrufit, mbllaçitet dhe përplas buzët, ndez radion pranë lavamanit. Por tani në drekë të gjitha stacionet janë kot, ndaj e lë fare radion.

- Pasqyra e javës, - ia bën Karli.

- Çfarë?

Ai ndonjëherë përdor fjalë që s'i kam dëgjuara më parë. Më lë gojëhapur e më kujtohen kohët e kaluara, kur truri nuk i ishte bërë ende si sfungjer i shkërmoqur dhe më tregonte gjithnjë histori.

- Kështu i quan Selma këto. Pasqyra e javës.

Qëllon që merr kapelën, e vë në kokë dhe pas tri sekondash më pyet se ku e ka kapelën. Po herë pas here seç i ndizen ca llapma në kokë dhe i kujtohet ndonjë gjë që i ka zënë pluhur për vite me radhë në ndonjë cep të trurit.

- Ne jemi këtu në fund të botës dhe jo në oborrin e mbretëror të Anglisë, - i them unë me njëlloj vrazhdësie.

Edhe unë kam ditët e mija të këqija. Dhe sot është një nga ato. Në mëngjes i kishte llangosur flokët me zamkë, kur po hante mëngjes i ndyu pizhamet e sapolara me të verdhë veze dhe kur doja ta fusja për ta larë, nuk donte dhe sillej si fëmijë i vogël.

- Po më shijon, - më tha. Ironia dhe cinizmi nuk zënë vend tek ai. Vetëm kur i bërtas, dridhet dhe më sheh i tmerruar. Sa herë e shoh kështu, më dhimbset aq shumë sa i kërkoj menjëherë të falur dhe i qëroj ndonjë mollë apo mandarinë.

- E po, kjo është e rëndësishme, - i them.

Gjyshen e njoh vetëm nga fotografitë, se e ka lënë Karlin që para se të lindja unë. Po nuk arrij ta kuptoj pse iu kujtua

pikërisht sot. Se, me siguri, shprehjen 'pasqyra javore' nuk e shpiku vetë. Për drekë kemi shnitcel të mbetur nga dje, lakër nga pardje, oriz nga e marta dhe kek me kakao nga java e kaluar. Ndaj dhe pasqyra e javës me duket gjetje shumë e goditur për drekën tonë.

- Mos harro të pish ilaçet, - i them duke ia shtyrë pjatën e vogël me tabletat që duhet të pijë.

- Faleminderit! - I fut të gjitha ilaçet njëra pas tjetrës në gojë dhe i gëlltit poshtë me një gllënjkë ujë.

Herë pas herë, jo shumë shpesh, përfytyroj si do të ishte po të vdiste Karli. Shumë rrallë them me vete: ah, sikur nesër ta gjej të vdekur në shtrat. Po të mos ia kishte mbathur, Karli do t'i kishte mbetur gjyshes në kurriz. Ai që pretendon se vendos vetë për jetën e tij, s'e ka idenë. Dhe, sigurisht, asnjë që ka ndonjë gjysh të mbaruar për t'u kujdesur.

Herët pasdite nxjerr tuk-tukun nga hangari. Rreth tre vjet më parë kisha parë në TV një emision për Indonezinë, në rrugët e së cilës lëviznin mijëra tuk- tukë. Horsti, një fshatar i zonës, më dha një motoçikletë të prishur, si shpërblim për riparimin e aparatit me të cilin milte lopët. Kur është fjala për gjëra teknike, jam shumë i zoti, se i kam mësuar në garazhin e Maslovit dhe nga librat. Tri javë pasi kisha marrë motoçikletën, bëra provën e parë me tuk-tukun tim. Më vonë e leva dhe e zbukurova dhe vazhdoj ende ta zbukuroj duke ngjitur gjithfarë gjërash në pjesët anësore dhe në mbulesën e kabinës: monedha, copa xhami të gdhendura dhe të lëmuara nga era dhe shiu, lodra plastike nga kutitë e drithërave, çelësa të vjetër, gurë shahu, guaska kërmilli, kapakë disqesh makine dhe një kafkë miu prej plumbi. Ndonjëherë më japin ndonjë gjë Maslovi, Horsti, Vili apo Otoja. Kështu, për shembull, një kapak të kuq për dritat e pasme të makinave, një kapak shisheje birre italiane, një kopsë manshete dhe një kartëmonedhë njëqindmarkëshe. Ana më dhuron herë pas here ndonjë karficë me gurë të

rremë apo ndonjë kapëse flokësh të thyer, që shkëlqen kur i bie dielli. Çdo javë shtoj ndonjë gjë të re.

E fut tuk-tukun në hije dhe hyj përsëri në shtëpi. Karli është ulur në stol, në kuzhinë, dhe vështron këpucët. Duart e rrudhura, pulla- pulla, gjithë damarë blu të kërcyer i ka vënë mbi gjunjë. Në disa fotografi që kam parë është i ri, i fuqishëm, një tip i hedhur me flokë të zinj dhe sy tërë shkëlqim, që rrezatojnë vendosmëri dhe forcë. Fotografitë ruhen në një kuti në dollapin e Karlit dhe pothuajse nuk arrij ta besoj se si ka mundësi që në to ka dalë i njëjti njeri që kam tani përpara dhe që nuk di si të lidhë këpucët.

Mundohem të mos e mendoj fare, po pikërisht kjo më tmerron më shumë: se një ditë do të jem ulur unë në atë stol të mallkuar, pa qenë në gjendje të mbaj mend ndonjë gjë nga jeta, se thjeshtë s'kam jetë.

- Është kollaj fare, ja shiko këtu, - i them Karlit duke u ulur në gjunjë e duke ia lidhur këpucën e majtë.

- Faleminderit! - thotë ai.

- Tjetrën lidhe vetë.

Karli ngurron pak, po pastaj kap lidhësen me gishta dhe e kryqëzon me vështirësi, po pastaj s'di ç'të bëjë më.

- Po tani?

- Kaloje njërën tek tjetra, - i them unë.

Karli bën ca lëvizje të ngadalshme pa kuptim dhe rënkon sikur po bën ndonjë punë shumë të rëndë.

- Lërë, lërë fare, - i them para se ta humbë plotësisht dhe ia rrëmbej lidhësen nga duart dhe e lidh vetë.

- Faleminderit! - thotë ai.

Ia vë helmetën në kokë, ia lidh rripat nën gushë dhe marr me vete edhe kutinë e biskotave me copat e prera të letrës. Gjyshi më falënderon edhe për këtë.

Në hangar kam një mikrobus të vjetër *VW*. Në të vërtetë është vetëm një karroceri gjysmë e mbuluar me mushama. Ndenjëset ia kam mbështetur pas murit dhe, për t'i mbrojtur nga pluhuri që fut era nga të çarat e dërrasave, i kam mbuluar me thasë plehu. Motorin e ka në një kuti

druri si në qivur. Maslovi rri disa javë dhe sjell herë pas here ndonjë pjesë këmbimi, po qëllon që nuk sjell gjë muaj të tërë. Po të vazhdojë kështu, autobusin do ta kem riparuar plotësisht vetëm kur të mbush tridhjetë vjeç.

Kurse Karli do të jetë nëntëdhjetë e pesë. Tani që e shoh duke ndenjur ashtu nën rrezet e dritës së mesditës, me helmetë në kokë dhe me shikimin e shkujdesur të hedhur larg si ndonjë astronaut i moshuar, them pa frikë se do të shkojë njëqind vjeç.

E ndihmoj të hipë në kabinë dhe ia vë kutinë e biskotave mes këmbëve.

- Ku do të shkojmë? - më pyet.

Njëzet herë më ka pyetur sot kështu.

- Tek Ana,- i them unë, ndërsa ai buzëqesh sikur të ishte ndonjë gjë e re e paparë.

I kërcej motorit dhe i bie pedalit. Motori ndizet tak-fak. Nuk e di nëse bëj si kujdestar për Karlin, po si mekanik, ama, nuk jam i keq.